

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar "MG2+" SHPK**  
**DT 13.12.2021**

Sipas Legjislacionit shqiptar dhe konkretisht ligjit nr.990l. dt.14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare". ligjit nr.9723. dt.03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit". i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe akte të tjera ligjore dhe nën ligjore në fuqi gjatë kohës së ushtrimit të veprimitarisë së shoqësisë tregtare.

Unë ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare « MG 2+ » sh.p.k në mbledhjen e parë themeluese të kësaj shoqërie hartoj dhe miratoj këtë Akt themelimi si më poshtë vijon :

**Neni 1**  
**Forma e shoqërisë**

Shoqëria tregtare « MG2+ » është organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar.

**Neni 2**  
**Emri, Sigla, Vula e shoqërisë**

Emërtimi i shoqërisë do të jetë « **MG2+** »

Shoqëria do të ketë vulën e saj të e cila do të identifikojë cdo dokument që ajo lëshon apo i përket shoqërisë.

Vula e shoqërisë njihet dhe pranohet nga të tretët duke filluar nga data e fitimit të personalitetit juridik të shoqërisë.

**Neni 3**  
**Adresa e selisë së shoqërisë**

Selia e shoqërisë është e vendosur në Lagjen "Hajro Cakerri", Rruga. "4 Heronjtë", ndërtesa nr.104, Vlorë, email: [studio.mg2plus@gmail.com](mailto:studio.mg2plus@gmail.com).

Ajo mund të transferohet në cdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. në bazë të vendimit të ortakut të vetëm ose të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, në varësi të numrit të aksionerëve në kohën e vendimarrjes.

Ajo mund të hapë ose mbyllë, filiale, degë ose zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.



**Neni 4**  
*Page 1/3*

## **Themeluesit**

Themelues i shoqërisë tregtare është Maltin Grabovaj:

### **Neni 5**

#### **Kapitali themelar i shoqërisë**

Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është 10,000 lekë (dhjetëmijë lek). Kontributi i ortakut është në vlerë monetare (lek).

Ortaku i vetem, Administratori ka 1 (nje) kuote ne masen 100% te kapitalit.

### **Neni 6**

#### **Qëllimi**

Shoqëria ka për qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar në kuadër të ligjit shqiptar që rregullon këtë fushë.

### **Neni 7**

#### **Objekti i veprimtarisë së shoqërisë**

Shoqëria ka për objekt:

- Shërbime konsulence për studim-projektim. Supervision punimesh, kolaudime për ndërtime civile, industrial.
- Infrastrukturë rrugore, aero-portuale, ujësjellës-kanalizime. Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh.
- Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore...etj. Ndërtime rrugësh kategoria e 5-të dhe e 6-të, rikonstruksione....etj.
- Shërbime të planifikimit urban.
- Shërbime konsulence inxhinierike dhe info inxhinierike.
- Vlerësime dhe monitorime mjedisore si dhe të eficensës energjitike.
- Import-eksport, tregtim i mallrave dhe produkteve industrial me shumicë dhe pakicë si dhe prodhimi i tyre në vend.



## **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë e pacaktuar. Ajo mund ta mbyllë aktivitetin e saj në cdo kohë më vendimin e ortakut të vetëm ose të asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

## **Neni 9 Përfaqësimi ligjor**

Shoqëria do të jetë një person juridik shqiptar dhe do të fitojë zotësinë juridike me regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 10 Organet e shoqërisë**

Shoqëria do të ketë strukturat e brendshme të mëposhtme:

- Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
- Administratori.

## **Neni 11 Regjistrimi i Shoqërisë**

Ngarkohet Z.Maltin Grabovaj që të merret me ndjekjen dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 12 Dispozita të fundit**

Rregullime më të hollësishme dhe specifike do jepen në statutin e shoqërisë tregtare. Gjithësesi korniza ligjore e këtij akt-themelimi dhe statuti është legjislacioni shqiptar dhe në mungesë të ndonjë dispozite të shprehur në mënyrë tekstuale do t'i referohet këtij legjislacioni.

Ky akt themelimi dhe Statuti bashkangjitur përgatitet në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë ligjore.

**Ortaku themelues  
Maltin GRABOVAJ**

*Maltin Grabovaj*

*Page 3/3*

*M*